

Shoqata
Mikrofinansca
Shqiptare



Albanian
Microfinance
Association

MIKROFINANCA SHQIPTARE 2023



TABELA E PËRMBAJTJES

DY FJALË NGA PRESIDENTI

SEKTORI I MIKROFINANCËS DHE ZHVILLIMET E TIJ

VEPRIMTARIA E ANËTARËVE TË AMA GJATË 2023

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË SHOQATËS GJATË 2023

NGJARJE SHËNJUESE

KËRKIME DHE PUBLIKIME

LOBIMI DHE ADVOKIMI



1 DY FJALË NGA PRESIDENTI

Mikrofinanca Shqiptarë e përfaqësuar nga 9 anëtarët e Shoqatës së Mikrofinancës, përmbylli dhe një vit tjetër me sfida dhe arritje të reja. Mikrofinanca nuk ka të bëjë vetëm me ofrimin e ndihmës financiare; ka të bëjë me fuqizimin e individëve dhe bizneseve për të arritur qëllimet dhe ambiciet e tyre dhe për të kontribuar në rritjen e ekonomisë së vendit. Bëhet fjalë për nxitjen e një kulture të sipërmarrjes dhe të mbështetjes te vetvetja, veçanërisht në komunitetet ku aksesit në shërbimet tradicionale bankare është i kufizuar.

Në rrugëtimin tonë drejt zhvillimit ekonomik, sektori mikrofinanciar ka luajtur një rol kryesor në sigurimin e aksesit në kapital për ata që kanë më shumë nevojë për të. Pavarësisht nëse është një biznes i vogël që kërkon të zgjerohet, një fermer që kërkon të investojë në të mbjellat e tij, ose një individ që përpiqet të përmirësojë jetesën e tij, sektori mikrofinanciar në

Shqipëri ka qenë aty për të ofruar ndihmën e tij.

Në këtë fjalë dua të shpreh mirënjohjen për Shoqatën Mikrofinanca Shqiptare, e cila është një nga iniciativat më të rëndësishme që na ka bashkuar në një zë të vetëm në përpjekjet tona për të përmirësuar dhe treguar rëndësinë e sektorit mikrofinanciar në Shqipëri.

Të gjithë anëtarët e sektorit mikrofinanciar dhe të kësaj shoqate luajnë një rol të rëndësishëm në këtë treg për edukimin financiar jo vetëm të individëve që ata financojnë, por edhe më gjerë nëpërmjet aktiviteteve që ata organizojnë në këtë drejtim. Të gjithë bashkë ne influencojmë të ardhmen duke dhënë njohuri mbi edukimin financiar, buxhetimin dhe kursimet, e në këtë mënyrë ne po i pajisim njerëzit tanë me mjetet që u nevojiten për të marrë vendime të informuara për financat e tyre, duke ndërtuar kështu një shoqëri më elastike financiarisht.

Për më tepër, industria e mikrofinancës ka luajtur një rol vendimtar në transformimin e individëve nga të pa-shërbyeshëm nga bankat, tashmë në individë që i kanë të gjithë përbërësit e duhur për tu shërbyer nga sektori financiar bankar. Nëpërmjet produkteve dhe shërbimeve financiare inovative të përshtatura për nevojat e komuniteteve të pashërbyera, ne kemi kemi bërë të mundur që tashmë banka të jetë një mundësi tjetër për ata që më parë ishin përjashtuar nga sistemi financiar bankar.

Për më tepër, angazhimi ynë ndaj inovacionit teknologjik jo vetëm që ka përmirësuar proceset, por ka hapur gjithashtu mundësi të reja për përfshirje financiare. Duke përqafuar platformat digjitale dhe zgjidhjet e bankingut celular, ne po arrijmë klientë edhe në zonat më të largëta, duke katalizuar rritjen ekonomike dhe duke reduktuar pabarazitë.

Ndoshta më e rëndësishmja, mikrofinanca ka transformuar mënyrën se si ne i qasemi kreditimit. Duke nxitur një marrëdhënie të bazuar në besim me klientët tanë, ne jemi larguar nga modeli tradicional i proceseve të gjata dhe dokumentacionit të tepërt. Në vend të kësaj, ne i japim përparësi transparencës, llogaridhënies dhe praktikave të përgjegjshme të huadhënies, duke fuqizuar klientët tanë të marrin në dorë drejtimin e të ardhmes së tyre financiare.

Ndërsa shohim përpara, ne vazhdojmë me vendosmëri të pranojmë angazhimin tonë për të avancuar sektorin e mikrofinancës në Shqipëri. Së bashku, ne kemi fuqinë për të nxitur zhvillimin e qendrueshëm, për të fuqizuar individët dhe komunitetet dhe për të ndërtuar një të ardhme më të begatë për të gjithë.

Faleminderit!

Arlinda MUJA
Presidente – Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

2 SEKTORI I MIKROFINANCËS DHE ZHVILLIMET E TIJ. PRIORITETET STRATEGJIKE DHE FUSHAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË

2.1 DISA ASPEKTE KRYESORE EKONOMIKE NË NIVEL NDËRKOMBËTAR E KOMBËTAR

Institucionet financiare jo-banka, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën licënsimin dhe mbikëqyrjen e Bankës së Shqipërisë, ndahen në disa nën-grupe, të cilat konsistojnë në:

- Institucione financiare jo-banka të kredidhënies;
- Institucione Financiare të mikrokredisë;
- Institucione financiare të qirasë financiare dhe/ose faktoringut;
- Institucione financiare jo-banka të pagesave; dhe

e) Institucione financiare jo-banka të emetimit të parasë elektronike.

Të gjitha këto institucione operojnë në tregun shqiptar nën Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë, dhe mbikëqyrjen kryesisht me të njëjtin kuadër rregullator si edhe bankat, me përjashtim të disave nga fushat e veprimtarisë së tyre, siç është administrimi i rreziqeve apo përllogaritja e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në fund të vitit 2023, sistemi financiar numëron 39

subjekte financiare jobanka. Gjatë këtij viti janë licënsuar dy subjekte të reja, "BKT Pay" si institucion i parasë elektronike dhe "New Collection", si institucion i blerjes dhe trajtimit të kredive me probleme. Ndërkohë, me kërkesë të subjektit, është kryer revokimi i licencës për institucionin e pagesave "Kastrati" shpk. Informacioni mbi veprimtarinë e subjekteve paraqitet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 1.

Nga ana tjetër, në tregun shqiptar operojnë edhe institucionet e kursim kreditit, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre nën një kuadër ligjor dhe rregullator të dedikuar. Institucionet më të mëdha të kësaj kategorie janë gjithashtu operatorë të mikrofinancës dhe anëtarë të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare. Aktualisht, Shoqata përbëhet nga 8 institucione financiare jo-banka, me veprimtari kredidhënien dhe mikrokredinë, dhe 2 institucione të kursim kreditit.

Tabela nr.1- Veprimtaritë e lejuara për institucionet financiare jo banka

Nr	Institucione Financiare Jo Banka	Para Elektronike	Shërbime të pagesave dhe transferimit të parave	Veprimtari me Rrezik Kredie						Këmbim Valutor	
				Kredidhënie	Mikrokredi	Qira Financiare	Faktoring	Shërbimet Këshilluese dhe ndërmjetësuese	Për ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve	Blerje Kredi me Probleme	Këmbim Valutor
1	Agro & Social Fund *(ASF)				✓						
2	Kredit Partner				✓						
3	Agro Kredit* -Ish FAF			✓				✓	✓		
5	Ak-Invest		✓	✓			✓	✓	✓	✓	✓
6	Albania Leasing					✓					
7	Albania Financial Institution (AFI)			✓		✓	✓	✓	✓		
8	Crimson Finance Fund Albania *			✓		✓	✓	✓			
9	Easy Pay	✓	✓							✓	✓
10	Fondi Besa *			✓				✓	✓		
11	luteCredit Albania *				✓						
12	Kredo Financë *				✓						
13	Landeslease					✓					
14	Mia Finance*				✓						
15	Credital				✓						
16	Virtus Lending					✓					
17	M-Pay	✓									
18	NOA *		✓	✓				✓	✓	✓	✓
19	Fab Invest shpk			✓			✓	✓			
20	Platinum Investment										✓
21	Porsche Leasing					✓					
22	Posta Shqiptare	✓	✓							✓	
23	Raea Financial Services		✓							✓	✓
24	Raiffeisen Leasing					✓					
25	Tirana Capital Trade						✓				
26	Tirana Factoring & Lease					✓	✓			✓	
27	Tranzit			✓		✓	✓	✓			
28	Unioni Financiar i Tiranës	✓	✓							✓	✓
29	Paysera Albania	✓									
30	Antigone Financial Enterprise					✓					
31	eReja shpk	✓									
32	RPay	✓									
33	Soft Solution	✓									
34	Lendal sh.p.k				✓						
35	Rubicon sh.a.	✓									
36	lutepay	✓									
37	Bkt Pay	✓									
38	New Collection								✓		

2.1. ECURIA E AKTIVEVE TË IFJB

Totali i aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit gjatë vitit 2023 ka njohur rritje me rreth 7 mld lekë ose 12%. Në dhjetor 2023, totali i aktiveve të këtyre subjekteve arrin në 65 miliardë lekë dhe përbën 3.3% të totalit të aktiveve të sistemit bankar.

Subjektet me peshën më të lartë në totalin e aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit janë: "Fondi Besa" (28%), "NOA" (21%) dhe "Iutecredit Albania" (11%).

Totali i aktiveve të IFJB-ve, miliardë Lek


Treguesi/mld lekë	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Totali i aktiveve të IFJB-ve	55.7	58	64.65

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në strukturën e aktiveve të IFJB-ve që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit, peshën kryesore e mban portofoli i kredisë me 73%. Pjesa tjetër është e shpërndarë në aktive likuide (14%), të tjera të arkëtueshme (9%) dhe mjete të tjera (përfshirë mjetet e qëndrueshme) (4%). Burimet parësore të financimit


për IFJB-të që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit janë huamarrjet (66% e pasivit) dhe kapitali i tyre (28%). Huamarrja përmes emetimit të titujve zë vetëm 1%. Përsa i përket origjinës së huamarrjeve, balanca anon lehtë nga jorzidentët me 52%.

Grafik 1 - Shpërndarja e aktiveve të IFJB-ve, dhjetor 2023




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2 - Shpërndarja e burimeve të financimit të IFJB-ve, dhjetor 2023




Grafik 3-Portofoli IFJB-ve dhe pesha e portofolit kundrejt sektorit bankar, dhjetor 2023



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4 - Portofoli IFJB-ve sipas objektivit të veprimtarisë, dhjetor 2023



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2. ZHVILLIMET NË TEPRICËN E PORTOFOLIT TË KREDISË DHE VËLLIMET E VEPRIMTARISË

Në fund të vitit 2023, portofoli i kredisë bruto për IFJB-të arrin në 53.6 miliardë lekë, duke njohur një rritje prej 6.23 miliardë lekësh (ose 13%) krahasuar me vitin paraardhës. Portofoli i kredisë bruto të IFJB-ve

arrin në 7.25% të totalit të kredisë së sistemit bankar, duke regjistruar një rritje prej 1 p.p. krahasuar me vitin paraardhës.

Tabela 2 - Ecuria e portofolit të kredisë mbi baza neto dhe bruto për totalin e SFJB-ve

Treguesi/mld lekë	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (bruto)	42.1	47.38	53.61
Totali i portofolit të kredisë për IFJB-të (neto)	37.4	42.02	47.15

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë së IFJB-ve mbahet nga subjektet e kredihënies dhe mikrokredisë (78%). Më pas renditet portofoli i qirasë financiare (21%), ndërsa pesha e portofolit faktoring mbetet më pak se 1%.

Aktiviteti me rritjen më të lartë edhe gjatë vitit 2023 ka qenë mikrokredia, me 5.2 miliardë lekë. Por duhet theksuar se kjo rritje është më tepër rezultat i ngjarjeve që ndodhin vetëm një herë. Konkretisht, gjatë vitit 2023, subjekti "NOA", një nga subjektet

me peshë të rëndësishme në treg, për herë të parë ka vendosur të raportojë një pjesë të portofolit të saj si mikrokredi (më parë i gjithë portofoli raportohet në segmentin e kredisë). Efekti i këtij riklasifikimi është 2.2 miliardë lekë (pra kjo shumë i zbritet portofolit të kredisë dhe i shtohet atij të mikrokredisë).

Ndërsa subjektet e mikrokredisë që në mënyrë konstante shfaqin rritjen më të lartë të aktivitetit janë "IuteCredit" dhe "Kredo Finance".

Tabela 3 - Ecuria e portofolit të kredisë bruto sipas veprimtarive të IFJB-ve

Veprimtarië financiare (në mld lekë)	Dhjetor 2021	Dhjetor 2022	Dhjetor 2023
Kredihënie	16.6	18.4	18.8
Mikrokredi	15.4	18.0	23.2
Qira financiare	9.6	10.4	11.2
Faktoring	0.5	0.4	0.4
Portofoli bruto	42.1	47.4	53.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2023, portofoli i financimeve të subjekteve që ushtrojnë veprimtarië e kreditimit është i balancuar në raportin 50%:50% midis bizneseve dhe individëve. Sektorët e ekonomisë më të financuar nga subjektet jobanka gjatë vitit 2023 kanë qenë

"Aktivitete të tjera shërbimi" (25%) "Tregtia, riparimi i automjeteve" (16%) dhe "Ndërtimi" (10%). Portofoli i IFJB-ve mbetet i orientuar drejt financimeve në monedhën vendase (68.6%) dhe me afat të mesëm maturimi (71.6%).


2.3. INSTITUCIONET ANËTARE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në planet e veta synon përfshirjen e të gjithë institucioneve financiare jo-banka që e gjejnë veten në aktivitetin, prioritetet dhe misionin e saj.

Institucionet anëtare të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare vazhduan me progresione rritje kreditimit e ekonomisë, madje pati një kërkesë në rritje për

kreditë nga bizneset. Veprimtaria mikrofinanciare gjatë vitit 2023 konsiderohet me rritje, indikatorë financiarë të qëndrueshëm dhe një administrim të kënaqshëm të burimeve në dispozicion. Anëtarët e Shoqatës në mënyrë të integruar kanë një portofol aktiv prej rreth 44.2 miliardë lekë dhe një portofol kredie prej rreth 36.6 miliardë lekë, me një rritje prej 9.2% dhe 7.2 % përkatësisht.


Grafik 6 - Portofoli aktiv dhe kredia e disbursuar në volum (shifrat në miliardë lek), dhjetor 2023



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Në vëllimin e kredisë së re bizneset zunë peshën më të madhe prej 51%, individët 36% dhe fermerët 12.5%.

Grafik 7 - Segmentimi i portofolit në volum kredie, dhjetor 2023




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Kreditë e akorduara në numër në total për vitin 2023 ishin 255,733, nga të cilat aktive në fund të dhjetor 2023 ishin 199,588. Ndërkohë, e parë në kredi të dhëna sipas segmenteve të tregut, kryesojnë kreditë akorduar për individët, të cilat zënë rreth 80% të numrit të përgjithshëm të kredive të dhëna gjatë vitit 2023.


Pas tyre renditen përkatësisht kreditë për bizneset dhe ato për bujqësinë, të cilat zënë përkatësisht 15% dhe 12.5% ndërkohë që rreth 0.5% e numrit të kredive të dhëna janë akorduar në kategori të tjera.

Grafik 8 - Volumi i disbursimeve sipas segmentëve të financuar




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Grafik 9 - Sektorët e mbështetur nga IFJB (shifrat në përqindje), dhjetor 2023




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Grafik 10 - Kreditë e dhëna dhe kreditë aktive në numër për anëtarët e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, dhjetor 2023



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare


Grafik 11 - Kredia mesatare e dhënë sipas segmentimit të portofolit, dhjetor 2023



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Kredia mesatare për sektorin është në përputhje me segmentet e tregut dhe nevojat e tyre, duke reflektuar në të njëjtën kohë edhe një shpërndarje të rreziqeve të marra përsipër nga institucionet tona.

Grafik 12 - Kreditë e dhëna në numër sipas gjinisë, dhjetor 2023




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Vihet re një rritje konstante në zonat urbane për shkak të lëvizjes brenda vendit dhe migrimit të vazhdueshëm të qytetarëve. Megjithatë ne vijojmë të marketojmë

produktet tona financiare edhe në zonat rurale, me fokus të veçantë bujqësinë dhe sipërmarrjen familjare në këto zona.

Grafik 13 - Kreditë aktive në numër sipas shpërndarjes gjeografike, dhjetor 2023



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare


Sektori i Mikrofinancës ka një zgjerim të madh fizik dhe si pasojë dhe një fokus në punësimin e duhur për të qënë në shërbim të klientit me cilësi dhe korrektësi. Sektori numëron mbi 1919 të punësuar, prej të cilëve 951 oficerë kredie. 10 institucionet e mikrofinancës numërojnë në total një rrjet prej 290 degësh të shtrira në gjithë vendin.

moshave duke patur një fokus në moshën 30-45 vjeç të cilët janë dhe moshë e cila vendos ekonominë më shumë në lëvizje.

Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet rritja e numrit të përfaqësuesve femra në nivel të lartë menaxherial. 63% e insitucioneve financiare jo banka ,anëtare tona kane staf drejtues gra nga 41%-60%

Gjithashtu sektori punëson profesionistë të gjitha

Grafik 14 - Numri i stafit të punësuar dhe degëve të anëtarëve të shoqatës ndër vite, dhjetor 2023




Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Përsa i takon cilësisë së portofolit të kredisë, sipas shifrave të raportuara nga anëtarët, gjatë vitit 2023 u reflektua një ulje e portofoleve në vonesë prej më shumë se 30 ditësh, indikator që qëndroi në vlerën e 6.1% për fundin e vitit 2023 kundrejt shifrës prej 7.2% për fundin e vitit 2022 (shifrat u referohen vetëm

anëtarëve të Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare).

Institucionet anëtare kanë marrë masat përkatëse duke rritur nivelin e provigjionimit për kreditë me probleme, kryesisht të financuara nga kapitali i vet dhe kontributet e aksionerëve në formën e injektimeve të reja.

Grafik 15 - Përqindja e kredive me mbi 30 ditë vonesë kundrejt totalit të kredive, dhjetor 2023



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

Gjatë 5 vjeçarit të fundit anëtarët e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare kanë investuar në teknologji në nivele të ndjeshme krahasimisht me nivelin total të shpenzimeve të tyre kapitale.

Vëllimi total i investimeve për periudhën e fundit 5 vjeçare kap shifrën prej më shumë se 17.7 milionë euro ekuivalent. Investimet në teknologji

përfshijnë modernizimin e sistemeve të brendshme të informacionit, automatizimin e proceseve, përputhshmërinë me parametrat e sigurisë së informacionit dhe digjitalizimin.


Sot një pjesë e mirë e anëtarëve ofrojnë kredinë online, si edhe shërbime të tjera financiare të ofruara nëpërmjet platformave digjitale.

të gjerë. Mbështet konsolidimin teknik dhe institucional të anëtarëve të saj, duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe duke identifikuar trendet financiare dhe ekonomike.

Viti 2023 ka qenë një vit me angazhime të rëndësishme nga ana e shoqatës dhe anëtarëve të saj. Gjatë këtij viti u konsolidua më tej pozicioni i Shoqatës si një aktor i rëndësishëm në nismat dhe zhvillimet që i takojnë tregjeve financiare. Nëpërmjet

bashkëpunimeve të vendosura dhe ndërveprimit institucional, Shoqata koordinoi veprimtaritë për të rritur nivelin profesional të qeverisjes korporative, aftësive institucionale për të përmirësuar klimën e sektorit financiar, nivelin e edukimit dhe përfshirjes financiare, standartet e larta të aftësive teknologjike që ofrojnë shërbim të shpejtë dhe me cilësi, duke ndikuar në eksperiencën e klientit, etj.

Grafik 16 - Investime në teknologjinë e informacionit (shifrat në lekë), dhjetor 2023



Burimi: Shoqata Mikrofinanca Shqiptare

2.4. REZULTATI FINANCIAR

Gjatë vitit 2023, IFJB-të që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit kanë gjeneruar një rezultat pozitiv neto prej 4.96 miliardë lekësh. Kthimi mesatar nga aktivet për IFJB-të që ushtrojnë veprimtaritë e kreditimit arrin

në 7.7% (kundrejt 4.8% në vitin 2022), ndërsa kthimi mesatar nga kapitali arrin në 37.4% (kundrejt 17.9% në vitin 2022).

2.5 VEPRIMTARIA E SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE DHE PRIORITETET STRATEGJIKE

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare operon në kontekstin specifik ekonomik me objektivin përfundimtar për t'i shërbyer zhvillimit ekonomik të ardhshëm të vendit, dhe në veçanti për të nxitur krijimin e vendeve të punës dhe përfshirjen financiare të individëve të vetëpunësuar, fermerëve, sipërmarrësve të vegjël dhe NVM-ve, përmes forcimit të sektorit të mikrofinancave dhe institucioneve që veprojnë në të .

Veprimtaria e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare

është pjesë e një përpjekje kolektive dhe të përbashkët midis institucioneve të saj anëtare, për të rritur vizibilitetin institucional në ndikimin që ka mikrofinanca në ekonominë kombëtare.. Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ka një rol të ndjeshëm në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës që rregullon veprimtarinë e mikrofinancës në Shqipëri, duke promovuar praktikat më të mira, duke ndarë njohuritë dhe duke prezantuar instrumente të reja financiare midis anëtarëve të saj dhe publikut

3 VEPRIMTARIA E ANËTARËVE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE GJATË VITIT 2023

Shoqata
Mikrofinansca
Shqiptare



Albanian
Microfinance
Association





3.1 | AGRO & SOCIAL FUND SHPK

Përgjatë vitit 2023, ndonëse në përmirësim, perspektiva e ekonomisë globale mbeti sërish e brishtë, në prani të inflacionit të lartë, si pasojë e luftës në Ukrainë dhe pasigurive të ushqyera nga trazirat në sektorin financiar të cilat u reflektuan edhe në ekonominë kombëtare.

Pavarësisht se viti 2023 ishte një vit me paqëndrueshmëri ekonomike ku efektet e rritjes së çmimeve nga njëra anë, apo rritjes së konkurrencës nga ana tjetër ishin të dukshme, rezultatet e Agro & Social Fund treguan se angazhimi i të gjithë hallkave të institucionit dhe rezultat pozitiv mbështetur gjithashtu edhe në strategjinë afatgjatë të institucionit. ASF po tregohet gjithnjë e më shumë me konsoliduar me kapacitete të forta menaxhimi si dhe me një ekip të kualifikuar për të përmbushur maksimalisht të gjithë objektivat e synuara.

Në mënyrë të përmbledhur, rezultatet e arritura nga ASF përgjatë 2023 janë si më poshtë:

- Administruam një portofol prej rreth 1.174 miliardë lekë. Në shifra kumulative përgjatë këtyre viteve iu është shërbyer rreth 33,551 klientëve, duke disbursuar rreth 7.3 mld Lekë.
- Në mbyllje të vitit 2023, 53.5% e klientëve i përkisnin zonave rurale dhe 44% klientë femra.
- Një staf prej 90 punonjësish ishte në shërbim të 3,511 klientësh.
- Gjatë vitit 2023, ASF zgjeroni aktivitetin e tij, duke hapur degën më të re rajonale, atë të qytetit të Fierit si dhe pati një lokacion të ri për nëndegën rajonale Tiranë.

Vijoi gjithashtu përgjatë gjithë vitit ngritja e fondeve me partnerin KIVA (vlerësuar për shkak të tarifave të ulëta të fondeve sipas kategorive të përcaktuara) si dhe në fund të vitit u nënshkrua një marrëveshje e re me Fondacionin Dorcas Aid International për projektin e titulluar "PËR NXITJEN E SIPËRMARRJES

NË RAJONIN E TROPOJËS dhe PUKËS NËPËRMJET KREDITIMIT".

Përgjatë vitit 2023, ASF mori pjesë në Konferencën e organizuar nga MFC, e cila u mbajt në Budva, ku gjatë së cilës u bë e mundur vendosja e kontakteve me disa huadhënës të mundshëm me të cilët ka vijuar shkëmbimi i informacioneve dhe pritet finalizimi i marrëveshjeve përgjatë vitit 2024. Gjithastu u zhvilluan takime me partnerë aktualë, me të cilët u bisedua për zgjerimin e bashkëpunimeve, te cilat gjithashtu pritet të finalizohen përgjatë vitit 2024. Tashmë e kthyer në një traditë, ASF mori pjesë në fushatën **Borrow Wisely**, fushatë kjo e iniciuar nga MFC, përgjatë gjithë muajit Tetor duke iu përshtatur risive që solli këtë vit sa i takon target grupit të përzgjedhur.



SYNIMET DHE STRATEGJIA PËR VITIN 2024

Bazuar në projeksionet e ngritura në Biznes Planin e periudhës afatshkurtër për vitin 2024, ASF synon:

- ASF deri në fund të vitit 2024 synon të ketë arritur në një portofol kredie me vlerë absolute prej 1.35 mld lekë dhe të ketë disbursuar kredi për rreth 3,026 klientë, me një shumë të disbursuar prej 968 mln lekë;
- ASF do të përdorë të gjithë burimet e veta, në formën më të mirë, për të mbajtur portofolin në risk në nivelin e parashikuar, ku PAR >30 jo më shumë 5% si dhe do të synojë shtimin apo përmirësimin e instrumenteve për dedektimin dhe kontrollin e risqeve kyçe që kërcënojnë organizatën; RAF, Vintage Analysis dhe Early Warning Flag.
- ASF deri në fund të vitit 2024 synon të zgjerojë shtrirjen dhe mbulimin me shërbime financiare në zona të tjera rurale e gjysmë urbane, nëpërmjet konsolidimit të zyrave ekzistuese si dhe shtimit të zyrave të reja (brenda degëve të konsoliduara ekzistuese);
- ASF synon të përmirësojë ofertën e produkteve të saj nëpërmjet përmirësimit të produkteve, në koherencë me zhvillimet, duke projektuar oferta të përkohshme asociuar me sezone specifike dhe duke iu përshtatur nevojave të klientelës.
- Në funksion të realizimit të synimeve mbi performancën dhe rritjen, ASF planifikon rritje të përqëndruar në degë të burimeve njerëzore me rreth 18%.
- ASF përgjatë 2024, por e shtrirë për të mundur përmbylljen në periudhën afatmesme (2024-2026), do të synojë të realizojë investime të qënësishme për garantimin e metejshtëm të sigurisë e integritetit të të dhënave, rritjen e cilësisë së punës me sistemin e informacionit dhe shërbesës ndaj rritjes së sigurisë kibernetike.





Crimson Finance Fund

3.2 CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA (CFFA)

Crimson Finance Fund Albania (CFFA) është një institucion financiar me një mision social për të rritur aksesin në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, start-upet dhe aktivitetet që gjenerojnë vende të reja pune. CFFA kërkon të mbështesë këto grupe ndërmarrjesh me financime dhe këshillim financiar duke i ndihmuar të dalin nga « rrethi vicioz i të qendruarit të vegjël ». Me një gamë të gjerë produktesh si kredi me këste, qira financiare (leasing), linjë kredie dhe faktoring, CFFA synon të mbulojë nevojat e këtyre ndërmarrjeve në investime, kapital qarkullues, apo shtim dhe përmirësim të aseteve fikse.

Crimson Finance Fund Albania financon sektorin e manufakturës tre herë më shumë se mesatarja e tregut financiar në proporcion me portofolin e saj, si edhe i dedikon rreth 25% të disbursimeve të saj start-upeve, duke u bërë kështu një promotor dhe një derë e hapur për këto të fundit, të cilët përfitojnë përveç financimit edhe një konsulencë të personalizuar falas në lidhje me planin e tyre të biznesit dhe projeksionet financiare.

Viti 2023 ka qënë një prej viteve më të suksesshëm për CFFA përse i përket performancës së tij, pavarësisht sfidave në treg në lidhje me rritjen e normave të interesit. Përgjatë këtij viti CFFA arriti të rrisë portofolin e tij me 42% (ose 55% pa konsideruar efektin e kursit të këmbimit) krahasuar me vitin 2022, duke e çuar atë në 780 milionë lekë. Kjo rritje u shoqërua gjithashtu edhe me një rritje të nivelit të disbursimeve me 43% (ose 57% pa konsideruar efektin e kursit të këmbimit) krahasuar me vitin 2022,

duke e çuar këtë nivel në 504 milionë lekë (20% mbi vlerën e buxhetuar). CFFA arriti gjithashtu të ulë nivelin e kredive me probleme në 4.3% në mbyllje të vitit 2023, si edhe të rrisë me 37% fitimin krahasuar me një vit më parë.

Viti 2023 shënoi gjithashtu një konsolidim të mëtejshëm të mardhënieve të CFFA me partnerë financiar vendas dhe të huaj si Banka Europiane e Investimeve, EBRD, dhe institucione të tjera financiare me mision zhvillimor.

Për herë të parë në fund të vitit 2023, CFFA publikoi Raportin e Impaktit.

Ky raport përmbledh 6 objektiva zhvillimor që CFFA ka në fokus: 1. Përfshirja financiare, 2. Aksesin në financë për start-upet, 3. Edukimi financiar dhe zbutja e informalitetit, 4. Barazia gjinore dhe krijimi i vendeve të punës, 5. Impakti social dhe mjedisor, 6. Shërbimi i sektorëve të pashërbyer.

CFFA synon të vazhdojë me vendosmëri përmbushjen e misionit të ortakëve të saj përgjatë vitit 2024, duke u bërë një aktor i rëndësishëm në tregun financiar vendas me pozicionimin midis bankave dhe institucioneve të tjera financiare përse i përket vlerës së financimit dhe kushteve të ofruara. CFFA do të vazhdojë të përqendrojë aktivitetin e saj në financimin e aseteve, aktivitetëve prodhues dhe start-up-ëve duke bashkëpunuar me institucione ndërkombëtare financiare që mbështesin financën sociale dhe synojnë rritjen e impaktit të hua-ve tona me qëllim ngushtimin e hendekut të aksesit në financë për ndërmarrjet mikro dhe të vogla.





3.3 FED INVEST SHKK

FED invest është një Shoqëri Kursim Krediti dhe është institucioni i parë pionier mikrofinanciar i krijuar në Shqipëri si rezultat i një nismë pilot të Bankës Botërore në vitin 1992. FED invest përfaqëson një kooperativë financiare me më shumë se 91 mijë anëtarë të shërbyer përmes 64 degëve në të gjithë vendin. Anëtarët e FED invest janë kryesisht fermerët, sipërmarrësit e vegjël, familjet rurale dhe urbane të përjashtuara nga shërbimet financiare bankare. Si një ndër insitucionet kryesore me prezencë në zonat rurale duke ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve financiare të përballeshme për popullsinë rurale, FED invest ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin social-ekonomik të Shqipërisë, me mbi 200 mijë kredi dhe gjysmë miliardë euro të injektuara në ekonomi gjatë 32 viteve të ekzistencës së saj. Për më shumë informacion në lidhje me FED invest ju lutemi vizitoni <https://www.fedinvest.al>

FED invest-i ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin në të gjitha drejtimet dhe të forcojë imazhin e institucionit në Shqipëri dhe te partnerët vendas e ndërkombëtarë. Krahas rritjes së qëndrueshme të portofolit të kredisë, është rritur edhe portofoli i depozitave, janë shtrirë shërbimet e pagesave utilitare në të gjitha degët e FED invest-it dhe janë rritur kapacitetet institucionale.

Gjatë vitit 2023 portofoli i kredive është rritur me 11.7%, duke arritur në 6.25 miliardë lekë. Rreth 50% e kredihënies së re prej 3.2 miliardë lekësh ka mbështetur aktivitetet në zonat rurale. Fokus të veçantë ka pasur financimi i SME-ve në sektorin e agroturizmit, turizmit malor dhe detar. Cilësia e portofolit të kredisë është ruajtur në parametra të kënaqshëm, me NPL prej 6.0%.

Gjithashtu, gjatë vitit 2023 portofoli i depozitave në FED invest është rritur me 4.8%, duke arritur në 5.3 miliardë lekë, mbështetur fuqishëm nga promovimi i depozitave MAX 12-mujore dhe 24-mujore, në Lekë dhe Euro. Ndërsa rritja e bazës së depozituesve prej 34% për vitin 2023 shënon rritjen më të madhe ndër

vite, duke konfirmuar edhe një rritje të brandit të FED invest në një treg mjaft konkurent të depozitave.

Treguesit kyesorë:

ANËTARË	91,372
DEGË	64
FSHATRA	3000
STAF	308 (64 % e stafit janë femra)

TOTALI I AKTIVEVE 7.85 MLD LEKË

MJAFTUESHMËRIA E KAPITALIT 20.1%

PORTOFOLI I KREDIVE 6.25 MLD LEKË

PORTOFOLI I DEPOZITAVE 5.29 MLD LEKË

Një sërë bashkëpunimesh të rëndësishme u realizuan gjatë vitit 2023 me partnerët tanë strategjikë përfshirë linja të reja të financimit dhe garancisë me përfitues fundorë sipërmarrësit e vegjël dhe të mesëm, si dhe me partnerë me të cilët FED invest bashkërendon përpjekjet për të ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve jo-financiare për fermerët dhe sipërmarresit në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë nëpërmjet Qendrës ABA dhe platformës abonline.al

FED invest do të vazhdojë të rritet në zonat urbane dhe rurale nëpërmjet produkteve të përshtatura dhe transparente për anëtarët: kredi, depozita, pagesa utilitare, llogari rrjedhëse, overdrafte, shërbime të digjitalizuara etj. FED invest-i do të vijojë investimet në teknologji dhe inovacion për të mbështetur proceset dhe shërbimet financiare dhe jo-financiare të digjitalizuara, si dhe për të ofruar transaksione të sigurta financiare për anëtarët tanë. Për më shumë informacion në lidhje me FED invest ju lutemi vizitoni faqen web <https://www.fedinvest.al>



3.4 FONDI BESA

1. TË DHËNAT BAZË TË AKTIVITETIT PËR VITIN 2023

Tregues	Dhjetor 2023
Kredi Aktive	26,357
Portofol Kredie ALL	14,416,899,724
Disbursime Numër/Vit	14,832
Disbursime Vlerë/Vit ALL	7,976,969,415
Mesatarja e Outst./Hua aktive	536,742
Mesatarja e Kredisë/Vit	537,822

*) Shifrat në Lekë

2. ARRITJET E AKTIVITETIT

- Portofoli i kredisë rezulton me rritje 2.2%, krahasuar me vitin 2022.
- Mesatarja e kredisë në vit rezulton me rritje 4.91% krahasuar me vitin 2022.
- Disbursimet në numër rezultojnë me rritje 3.24%, krahasuar me vitin 2022.
- Disbursimet në vlerë rezultojnë me rritje 8.30%, krahasuar me vitin 2022.

3. SFIDAT E AKTIVITETIT

- Qendrueshmëri në nivelin e disbursimeve, duke konsideruar një treg mikrofinanciar në nivel "stanjacioni". Është rritur numri i disbursimeve si në numër ashtu edhe në vlerë.
- Është rritur portofoli i kredisë.
- Është punuar intensivisht për implementimin e sistemit të ri.
- Është punuar për të menaxhuar riskun e përkeqësuar gjatë vitit duke synuar përmirësimin gjatë vitit aktual.
- Është punuar për mbështetjen e stafit në të gjitha

nivelet në këtë vit të vështirë.

- Janë realizuar kontakte efektive dhe nënshkruar marrëveshje me donatorë të ndryshëm për sigurimin e fondeve.
- Është punuar në vijimësi për ndjekjen dhe performacën e kredive Writen-Off.

4. RRTIJA E STAFIT

Krahasuar me një vit më parë, pra me fundin e vitit 2022, sipas të cilit stafi total prej 623 punonjësish shënoi një rritje prej 3% apo 18 punonjës në numër, viti 2023, deri më datë 31 Dhjetor 2023 ku stafi total përbehej prej 620 punonjës, shënoi një rënie prej 0.5% apo 3 punonjës në numër.

5. SHTRIRJA E AKTIVITETIT

Në përfundim të vitit 2023, Fondi Besa operon me 77 zyra afërsisht në të gjithë vendin, nga ku 34 janë Zyra Rajonale dhe 43 prej tyre Zyra Satelite (+ 1 Zyrë Qëndrore).

Çdo Degë Rajonale ka në varësi 1 – 2 zyra satelite në të njëjtin qytet ose në qytetet më të afërta.

6. PRIORITETET STRATEGJIKE & OBJEKTIVAT PËR PERIU DHËN 2024 - 2026

Në vijim të objektivave strategjike, Fondi Besa do të synojë të përmbushë si më poshtë:

- Të ruajë një portofol outstanding në shumën 19.5 miliardë lekë dhe një klientelë aktive prej 50,000 klientësh në fund të vitit 2026.
- Të ruajë një portofol në risk jo më shumë se 4-5% gjatë tre viteve të ardhshme.
- Të rrisë produktivitetin e personelit duke arritur 140 kredi aktive nga fundi i vitit 2026.
- Të ruajë dhe të përmirësojë vetëmjaftueshmërinë financiare gjatë tre viteve të ardhshme.

- Të ruajë treguesit në përputhje me rregulloret mbikqyrëse të Bankës së Shqipërisë.
- Të forcojë dimensionin social, ku do të synohet të rritet përfshirja financiare e grave me synimin e disbursimit të rreth 5,000 kredive në vit. Nëpërmjet aktivitetit të krëdihënies, ne synojmë të financojmë rreth 2,500 sipërmarrje të reja në vit, duke krijuar mundësinë e ruajtjes së rreth 10,000 vendeve të punës, për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.





3.5 IUTE ALBANIA

IuteCredit Albania sh.a është themeluar si një shoqëri aksionare më 4 Gusht 2014 dhe vepron në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjet e tjera që rregullojnë biznesin në Shqipëri. Në regjistrin tregtar (QKB) shoqëria është e identifikuar me NIPT-in L42011023U dhe selia kryesore e saj ndodhet në adresën: Rruga "Andon Zako Çajupi", ND.3, Hyrja Nr.2, Njësia administrative Nr.5, Tiranë. "IuteCreditAlbania" Sh.a zotërohet plotësisht nga aksioneri i vetëm shoqëria "Iute Group As" me qendër në Estoni.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë janë aktivitetet në fushën e kredidhënies dhe shoqëria është licencuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë me licencën Nr. 32, datë 31.03.2015 si Institucion Financiar Jo-Bankar i Mikrokredisë. Shoqëria e filloi veprimtarinë e saj duke ofruar kredi konsumatore në Prill 2015.

Vizioni

Njerëzit do të përdorin shërbime financiare të shpejta dhe do të transferojnë para menjëherë. Ne jemi pjesë e kësaj të ardhmeje. Përvoja e jashtëzakonshme e klientëve është arsyeja përse njerëzit do të kthehen sërish.

Misioni

Misioni i Iute është të krijojë një përvojë të jashtëzakonshme në financat personale, duke tejkuluar pritshmëritë e klientëve.

Qëllimi është përmirësimi i standardit të jetës së gjithësecilit, duke iu dhënë mundësinë të përdorin teknologji moderne dhe qasje në ekonominë digjitale. IuteCredit Albania i garanton të gjithë klientët me produktet e kredisë, të cilat janë kredi konsumatore pa garanci, me maturitet nga 1 deri në 48 muaj. Shoqëria është pjesë e Iute Group As me qendër në Estoni, e cila është e listuar në bursën e Frankfurtit, dhe që është aksioneri 100% i kapitalit të IuteCredit Albania.

Edhe viti 2023, ashtu sikurse viti para-ardhës, ishte një vit pozitiv në drejtim të rritjes që pasqyron gjithashtu

zhvillimin e IuteCredit Albania në zgjidhje plotësisht të digjitalizuara për klientët, për praktika më të qëndrueshme të kreditimit, për shumica më të mëdha kredie në periudha më të gjata dhe me norma interesi më të ulëta. Gjatë vitit 2023 përqindja mesatare vjetore (APR) e kredive të disbursuara është ulur përsëri në 45,84% nga 54,3% që ishte gjatë vitit 2022, ndërsa tendenca për vitin 2024 është të ulet deri në 35%.

Digjitalizimi në ofrimin e shërbimeve tona vazhdoi të ishte një ndihmë e cila ndikoi në rritjen gjatë 2023.

Një fokus i veçantë i është kushtuar investimit në sigurinë kibernetike. Sulmet me të cilat u ballafaquan disa nga institucionet në vendin tonë, bënë që edhe ne të rishikonim politikat e sigurisë dhe të përmirësojmë infrastrukturën për të ofruar garanci për të dhënat e klientëve por edhe për të ruajtur reputacionin e kompanisë.

Viti 2023 ka shënuar përmirësime në shumë tregues financiarë krahasuar me një vit më parë.

Totali i aktiveve të shoqërisë në 2023 u rrit me 7% krahasuar me vitin 2022, të ardhurat u rritën me 16%, ndërsa fitimi u rrit me 126%, krahasuar me një vit më parë. Humarrja e fondeve për të siguruar likuiditet të mjaftueshëm është një proces normal i kompanisë. Burimet janë të diversifikuara, duke marrë fonde hua në tregun vendas dhe atë të huaj. Normat e huamarrjes nuk kanë ndryshuar në raport me vitin 2022, për fondet e huaja, ndërsa mund të theksojmë se kanë ardhur në rënie për tregun vendas. Ky është një tregues shumë i mirë për të matur nivelin e riskut që na vlerësojnë institucionet financiare jo banka dhe ka bërë që IuteCredit të rrisë me huamarrjen në tregun vendas me kosto më të ulët, duke e reflektuar këtë edhe në kreditë që i ofron klientëve. Viti 2023 u finalizua me emetimin e 2 obligacioneve korporative me ofertë private për IuteCredit Albania për një vlerë prej afro 3 milionë euro.

Portofoli neto i kredisë në fund të 2023, rezultoi me 17% rritje nga viti i kaluar. Cilësia e kredisë vazhdon të jetë shumë e mirë ku edhe në fund të

2023 ripagesat e kredive brenda harkut kohor të 30 ditëve me vonesë përbëjnë 86%.

Numri total i klientëve u rrit me 15.3% ndërsa ai i klientëve aktiv të mirë u rrit me 2.7% krahasuar me të dhënat e një viti të mëparshëm. Numri i punonjësve në fund të vitit 2023 ra me 10% krahasuar me vitin 2022, ku rënia ka ardhur për shkak të ristrukturimit të kompanisë dhe orientimit drejt shërbimeve online më shumë sesa ato në degë.

IuteCredit Albania vijon investimet në zhvillimin dhe përmirësimin e kompetencave dhe aftësive të punonjësve të saj duke krijuar një mjedis nxitës të zhvillimit përmes programeve të trajnimit, ku gjatë vitit 2023 secili punonjës ka kryer mesatarisht 2 trajnime të ofruara nga trajnues të huaj, me një vlerë total prej 45,000 Euro.

Ne gjithashtu këshillojmë dhe mbështesim klientët tanë në shumë kanale të tjera komunikimi: telefon, Email, Facebook, WhatsApp, Viber, biseda në internet ku ofrojmë përvojë të pandërprerë të klientit. Qendra jonë e kontaktit u është përgjigjur me sukses 1,069,023 kërkesave nga klientët në 2023 dhe ne iu përgjigjëm 79.03% të thirrjeve tona në më pak

se 20 sekonda dhe u shërbyem klientëve tanë me kënaqësi dhe profesionalizëm.

Edhe këtë vit, si çdo vit tjetër IuteCredit Albania vijoi përfshirjen në aktivitete me karakter dhurues në vlerë totale prej 13,000 Euro.

Pritshmëritë në të ardhmen – Viti 2024

IuteCredit Albania ka disa pritshmëri për vitin 2024:

1. Zgjerimin e natyrës së produkteve dhe shërbimeve për klientët tanë
2. Investime të pandërprera në Financat Digjitale,
3. Investime në rrjetin e ATM-ve në të gjithë Shqipërinë
4. Investime në procese teknologjike specifike si: identifikimi elektronik i klientëve dhe nënshkrimi elektronik i tyre përmes ofruesve të besuar të shërbimit
5. Rritja e vazhdueshme e treguesve kryesorë financiarë
6. Produkti i kredisë për bizneset






3.6 | KREDO FINANCË


Viti 2023 nisi si një vit premtues, dhe në fakt pa-
varësisht se muaji Prill e lëkundur pak besimin për
vazhdimësinë e vitit, më pas puna e palodhur e të

gjithë punonjësve u shpërblye me një vazhdimësi të
palëkundur dhe në rritje për muajt në vijim.



Siç shihet qartë edhe nga grafiku, ky vit solli një
trend më të njohur të dinamikës ekonomike. Duke
mbajtur në të njëjtat nivele aplikimet në total përgjatë
gjithë pjesës së parë të vitit. Vetëm në muajin Shtator
shohim një fillim të një rritje, e cila kulmoi në Tetor
të vitit 2023. Peshën kryesore të kësaj rritje e mbajti
produkti i Kredisë me këste, duke na treguar edhe
një herë rëndësinë që ka për individin një ndarje e
shpenzimeve në kohë. Muaji Dhjetor dëshmon një
rritje marramendëse si në numër aplikimesh ashtu
dhe në kredi të disbursuara.

Janë disa faktorë që sollën këtë stabilitet dhe rritje
në vitin 2023. Kredo Financë gjatë vitit 2023 ka
qëndruar besnike me strategjinë e saj për të ofruar
produkte me ulje tek konsumatorët besnikë, por



gjithashtu si edhe çdo vit tjetër ka ndihmuar të gjithë
klientët e rinj duke vazhduar së ofruari në treg ofertën
e saj fantastike – KREDIA E PARË FALAS!

Shëndeti i një kompanie duket qartë nga niveli i
klientëve të përsëritur që kjo kompani arrin të mbajë.
Ashtu siç duket dhe qartazi nga grafiku më sipër,
Kredo Financë mbështetet fort tek klientët e përsëritur.
Në grafikun më sipër shohim se portofoli i Kredo
Financë për vitin 2023 përbëhet më së shumti, 76%
nga kredi të përsëritura, dhe vetëm 24% nga kredi të
cilat gjenerohen nga klientë të rinj për Kredo Financë.

Kredo Financë në mënyrë që të rrisë cilësinë e
shërbimit të saj ka investuar tej mase tek automatizimi
i proceseve dhe përmirësimi i të gjitha hallkave
ndërlidhëse midis punonjësve të saj.

Gjatë vitit 2023 shohim se kemi një stabilitet në
numrin e stafit në krahasim me 2022, gjë që tregon
për besnikërinë e stafit ndaj institucionit. Në fund të
vitit 2023 Kredo Finance shënon 230 punonjës të
cilët drejtojnë dhe ndjekin punën për të shërbyer të
gjithë klientët e saj në 38 degë.

Nuk mund të quesh Fintech nëse nuk sjell produkte
ose procese të reja në treg. Gjithmonë në krye të
zhvillimit teknologjik Kredo Financë gjatë vitit 2023
përfundoi negociatat me kompaninë Evrotrust.

Një nga avantazhet kyçe të Kredo.al është partneriteti
me EvroTrust, një kompani lider në sigurinë digjitale.
Përmes EvroTrust, Kredo.al mundëson një proces të
identifikimit 100% online, duke përfshirë verifikimin e
dokumentit të identifikimit, identifikimin biometrik dhe
firmosjen digjitale për klientin.

Verifikimi i dokumentit të identifikimit: Për të garantuar
sigurinë dhe ligjshmërinë, EvroTrust mundëson
një verifikim të saktë të dokumentit të identifikimit
të klientit. Ky proces siguron që të dhënat janë të
vlefshme dhe që klienti është i përshtatshëm për kredi.

Hedhja në treg e kësaj risie do të jetë në fillim të vitit
2024.

Planet e së ardhmes

Planet tona janë afatgjata dhe ambicioze.

Për vitin 2024 Kredo Financë planifikon:

1. Të zgjerojë dhe më tej rrjetin e saj të shërbimeve
2. Të zgjerojë ndikimin e saj në rritjen e nivelit të edukimit financiar
3. Të rrisë kapacitetin performues të stafit të saj nëpërmjet një programi intensiv dhe specifik trajnimesh profesionale dhe personale





3.7 | MIA FINANCE

MiA Finance sh. a është një institucion mikrofinanciar jobankë, i themeluar në vitin 2007, me kapital 100% shqiptar, i licencuar nga Banka e Shqipërisë në vitin 2010 për veprimtari mikrokredie. MiA finance kryen shërbime në 10 degë të shpërndara në të gjithë Shqipërinë.

Mia Finance sh.a synon që të vazhdojë të përmirësojë dhe konsolidojë imazhin e saj nëpërmjet punës së pandërprerë të stafit profesional, duke patur gjithmonë parasysh parime të padiskutueshme si cilësia, transparenca dhe fleksibiliteti ndaj klientëve dhe duke i trajtuar klientët në mënyrë të barabartë, pavarësisht kushteve personale, sociale apo demografike. Besueshmëria e klientëve është prioriteti ynë dhe na shtyn që të punojmë akoma më fort për të arritur një pozitë të favorshme në treg si institucioni më i besueshëm financiar, me një etikë të lartë profesionale. MiA Finance ofron produkte financiare për të gjitha llojet e klientëve. Grupet e synuara janë bizneset e vogla e të mesme dhe agrobizneset.

MiA Finance ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin në të gjitha drejtimet dhe të forcojë imazhin e institucionit në Shqipëri dhe te partnerët vendas e ndërkombëtarë. Gjatë vitit 2023 portofoli i kredive është rritur me 149%, duke u fokusuar vazhdimisht në rritjen e portofolit të kredisë dhënë bizneseve mikro dhe agro. Cilësia e portofolit të kredisë NPL është ulur në mënyrë të konsiderueshme në 13.88%.

Treguesit kyesorë:

DEGË 10 (70% e tyre janë çelur gjatë 2023)
STAF 60 (75% e stafit janë femra)

Ndër këto, një sërë bashkëpunimesh të rëndësishme u realizuan gjatë vitit 2023 me partnerët tanë. Plot 7 degë janë hapur gjatë vitit 2023.

MiA Finance do të vazhdojë të rritet në zonat urbane dhe rurale nëpërmjet produkteve të kredisë të përshtatura dhe transparente për klientët.

Fokus gjatë vitit 2024 do të jenë:

- Hapja e degëve të reja MiA
- Diversifikimi dhe rritja e portofolit të kredive në volum dhe numër
- Promocion i vazhdueshëm në media të ndryshme
- Sponsorizime, etj.

Për më shumë informacion në lidhje me MiA Finance ju lutemi vizitoni faqen web <https://miafinance.al/>





3.8 | NOA

Prej 25 vitesh, NOA ka arritur t'i përgjigjet me sukses kërkesës në rritje të sipërmarrësve, fermerëve dhe familjeve shqiptare për financime të përshtatura e përherë më ambicioze. Dhe viti 2023 e simbolizon më së miri këtë realitet teksa portofoli i financimit aktiv i tejkaloj 80 milionë euro me një rritje vjetore prej 25%. Me po kaq është rritur dhe numri i disbursimeve të reja çka konfirmon faktin se NOA ka mbetur besnike e segmenteve të saj prioritare duke ofruar të njëjtat produkte, por me një kapacitet ofrues, procesimi dhe ndjekjeje më dinamik. Është ky reputacion tanimë i konfirmuar ndër vite i produkteve dhe ofertës financiare të NOA që shpjegon faktin se 1 në 2 klientë gjatë vitit 2023 të jenë klientë të NOA për herë të parë. Rritja e portofolit gjatë vitit 2023 duhet lexuar gjithashtu nën optikën e rritjes së kostove të fondeve e cila e tejkaloj 13%. Është falë kapacitetit të NOA-s për të krijuar ekonomitë e shkallës së nevojshme në rrafshet teknologjike, të biznesit e financiare që rritja e kostove nuk impaktoi aktivitetin kredidhënës. Përkundrazi, shërbeu si një incentiv për të ofruar një shërbim dhe më cilësor, çka konfirmohet dhe nga nivelet e PAR30 i cili mbeti në nivelin e 3.4%.

Ndërkohë, në rrafshin institucional, tre do të ishin arritjet më të spikatura të NOA. Së pari, shtrirja e aktivitetit kredidhënës përtej kufirit duke hapur dhe degën e parë në Kosovë. Një arritje operationale por dhe një pasqyrë e vizionit të NOA për të ofruar një financë njerëzore kudo ku gjenden rrënjët e komuniteteve tona. Së dyti, emetimi me sukses për herë të parë në Shqipëri të një obligacioni privat të hapur. Nënshkrimi i tij brenda një kohe rekord nga institucione private dhe individë të shumtë, është dëshmia më e fortë e besimit që logo-ja e NOA përcjell në tregun shqiptar. Së treti, vlerësimi deri në nivel finalist të NOA, krahas Balfin Group dhe Credins Bank, në kuadër të nismës organizuar nga UNDP "SDG Business Pioneers Award". Një çmim i cili konfirmoi se investimi gjatë viteve të fundit në promovimin e një Finance Njerëzore është përkthyer

në terma reale e të prekshëm dhe për palë të treta të specializuara në çështjet ESG. Në këtë rregjistrë, na duhet të përmëndim dhe Çertifikatimin e Mbrojtjes së Konsumatorit, si një arritje e cila dëshmon investimin e të gjithë stafit të NOA në kapjen e standardeve më të larta.

Tipare dalluese, evente apo rezultate të spikatura gjatë vitit 2023

- Hapja e NOA Kosovë
- Emetimi për herë të parë në Shqipëri i një obligacioni me ofertë publike
- Konferenca e Balkans Economic Forum
- Pjesëmarrjet në panairë
- Donacionet
- Çertifikata CPC

Prioritetet strategjike dhe objektivat për vitin 2024

Ky është një vit i mbushur me sfida që na motivojnë dhe na shtojnë për të ecur përpara. Në përputhje me objektivat tona të biznesit për të arritur në fund të vitit 2024 një portofol kredie prej rreth 110 milionë EURO, ne po synojmë të implementojmë modelin e një institucioni financiar që respekton parimet e një Finance Njerëzore dhe që ofron shërbimet e veta nëpërmjet vizionit të NOA 3x3 ku dega digjitale ka marrë prioritet absolut, pa lënë pas rrjetin e partnerëve dhe sigurisht kanalën tonë kryesor të biznesit, rrjetin e degëve. Përveç pozicionimit në treg, prioritetet tona strategjike mbështetëse janë automatizimi i plotë i proceseve të brendshme si edhe diversifikimi i linjave të reja të biznesit, për të ofruar tek klienti produkte dhe shërbime të reja përveç atyre të kredisë. Këshillimi mbetet një nga linjat që do të vijojnë të tërheqim gjithmonë e më shumë vëmendje. Në linjë me strategjinë tonë të zhvillimit të biznesit, segmenti i biznesit të vogël do të marrë një vëmendje të veçantë për të siguruar një pozicionim po aq të favorshëm si segmentet individë, mikro dhe agro.

Një set i plotë produktesh, me kritere dhe procese të thjeshtuara do të jetë vazhdimisht në dizajnim dhe prezantim tek klienti, për të siguruar një nivel të lartë inovacioni dhe ripozicionimi në treg.

Struktura e re e biznesit që u prezantua në fillim të shkurtit 2024 ka filluar nga puna për ekzekutimin e strategjisë së saj për këtë vit, dhe shifrat e tremujorit të parë janë jashtëzakonisht inkurajuese. Mbetemi

besimplotë që me kapacitetet që kemi, energjinë dhe kurajon që na karakterizon, komunikimin njerëzor dhe bashkëpunimin në shkallë sipërore, objektivat që i kemi caktuar vetes dhe prioritetet strategjike që kemi marrë përsipër, do të arrihen dhe tejkaloen për të forcuar edhe më tepër pozicionimin e Institucionit Financiar NOA në tregun financiar lokal dhe atë ndërkombëtar.





3.9 UNIFIN SHKK

UniFin SHKK është një institucion jofitimprurës, i cili ndryshe nga shumica e institucioneve të tjera financiare zotërohet në tërësi nga anëtarët e saj. Fitimet e gjeneruara nga produktet e kredisë riinvestohen në kapitalin e SHKK-së me qëllim zgjerimin e aktivitetit të kredihënies për anëtarët e saj me qëllim përmbushjen e nevojave financiare me kushte sa më të favorshme për anëtarët. Fondi i kredisë për anëtarët ka si burim depozitat e grumbulluara nga po anëtarët e SHKK-së.

Duke u mbështetur në vlera dhe parime të tilla si solidariteti, transparenca dhe integriteti, SHKK UniFin është një nga partnerët më të besueshëm në fushën e mikrofinancës në vend.

Viti 2023 ishte një tjetër vit i suksesshëm dhe pozitiv. UniFin shënoi rritje në të gjithë treguesit e saj. UniFin hapi 4 degë të reja duke zgjeruar hartën e saj gjeografike në veri dhe duke hapur degë të reja në qytetet ekzistuese Korçë e Tiranë. Anëtarësia u rrit me 10%, u rrit vëllimi i kredive të disbursuara me 21% duke çuar në rritjen e portofolit të kredisë me 17% dhe ai i depozitave me 2%, që në fund rezultuan në rritje të kapitalit të SHKK-së me 13.4%.

Viti 2023 shënoi gjithashtu një qendrushmëri në cilësinë e kredisë duke e mbajtur nivelin e rikut brenda objektivave të SHKK-së deri në 2.7%.

Të dhënat e Shkk UniFin për fundin e vitit 2023 janë si më poshtë:

- Totali i numrit të anëtarëve: 20,973 anëtarë
- Totali portofolit bruto të kredisë: 1,183,500,000 lekë
- Totali i portofolit të depozitave: 1,061,400,000 lekë
- Totali i degëve: 21
- Numri i punonjësve: 50

Zhvillime të rëndësishme kanë ndodhur në drejtim të hartimit të produkteve të reja të kredisë dhe të depozitave të cilat sollën kushte në përputhje me kërkesat e anëtarësisë dhe të tregut në përgjithësi dhe pa ulur cilësinë e kredisë dhe duke mbajtur kostot e fondeve në një nivel të pranueshëm.

Synimet dhe strategjia për vitin 2024

Viti 2024 ka si synim rritjen e mëtejshme dhe cilësore të portofolit të kredisë nëpërmjet produkteve fleksibël të huasë që synojnë të plotësojnë një gamë të gjerë nevojash për anëtarët, që nga nevojat e thjeshta konsumatore, mbështetjes për biznesin e vogël e të mesëm dhe deri te nevojat e financimit për blerje shtëpie.

SHKK UniFin ka si objektiv ndërtimin e një strategjie afatmesme për digitalizimin e produkteve dhe proceseve për të rritur në mënyrë më të shpejtë e më efektive komunikimin me anëtarët.

Edhe për vitin 2024 SHKK UniFin do të vijojë partneritetin me partnerët e saj historikë dhe të rinj me të cilët ndan të njëjtin mision dhe qëllim.



4 PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË SHOQATËS GJATË VITIT 2023

4.1. TRAJNIME DHE SEMINARE ME TEMATIKA KYÇE TË SEKTORIT

4.1.1 Shoqata Mikrofinanca Shqiptare zhvilloi një seminar dy ditor me temë: "Rreziqet e financimit të terrorizmit të paraqitura nga teknologjitë e reja në kontekstin shqiptar", 28 Shkurt 2023 - 1 Mars 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (AMA) në bashkëpunim me Royal United Service Institute (R.U.S.I) ,Centre for Financial Crime & Security Studies (CFCS) dhe Albanian Financial Intelligence Unit (AFIU) zhvilluan seminarin dy ditor i cili eksploro: "Rreziqet e financimit të terrorizmit të paraqitura nga teknologjitë e reja në kontekstin shqiptar".

Inovacionet në shërbimet financiare në vend ofrojnë përfitime të shumta për njerëzit e zakonshëm, duke përfshirë përvojë më të mirë të përdoruesit dhe pagesa më të shpejta, por platformat digjiitale dhe teknologjitë e reja në mënyrë të ngjashme mund t'u mundësojnë terroristëve dhe financuesve të tyre të mbledhin, lëvizin, ruajnë dhe shpenzojnë fonde.

Abuzime të tilla të teknologjive të reja janë pikërisht në krye të agjendës globale të financimit të antiterrorizmit (CTF), me vendet në mbarë botën që kërkojnë të arrijnë ekuilibrin delikat të, nga njëra anë, çlirimin e potencialit pozitiv të teknologjive të reja financiare për përfshirje financiare dhe akses në banka, ndërsa nga ana tjetër zhvillon rregullimin dhe njohuritë e duhura brenda vetë sektorit të teknologjisë së re.

Sesionet u drejtuan nga studiues të R.U.S.I dhe ekspertë të tjerë kryesorë të krimit financiar në industrinë e teknologjisë financiare (FinTech), duke u fokusuar në ndihmën e pjesëmarrësve të sektorit privat që të parashikojnë se si shërbimet e tyre mund të abuzohen potencialisht nga terroristët ose mbështetësit e tyre. Dita e dytë mbledhi pjesëmarrësit e sektorit publik dhe privat, për të diskutuar së bashku rreziqet dhe për të parë avantazhet e bashkëpunimit të trajtuar financimin e terrorizmit.



4.1.2 Shoqata Mikrofinanca Shqiptare zhvilloi një tryezë të përbashkët diskutimi me UNHCR Albania në kuadër të: "Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve dhe Azilkërkuesve" 20 Qershor 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në bashkëpunim me UNHCR Albania, organizuan një tryezë të përbashkët diskutimi në kuadër të: "Ditës Ndërkombëtare të Refugjatëve dhe Azilkërkuesve". Qëllim i kësaj tryeze ishte perfaqësimi, ndërgjegjësimi për vlerësimin e nevojave financiare dhe ligjore të refugjatëve. Kjo shërben për të kuptuar përfshirjen e tyre, dokumentacionin e duhur, kërkesën për përdorimin e shërbimeve financiare në vend, dhe vlerësimin e interesit nga ofruesit e shërbimeve financiare si edhe shtrirjen e produkteve dhe shërbimet e tyre tek popullata refugjate.

Nga ana e Shoqatës u prezantuan mundësitë për sektorin financiar për t'u shërbyer refugjatëve dhe praktikant më të mira të ndjekura nga ofruesit e shërbimeve financiare në vende të tjera.

Nga ana e UNHCR Albania pjesëmarrësit u njohën me situatën socio-ekonomike të refugjatëve, kuadrin ligjor dhe nevojat e jetesës, si edhe me praktikant aktuale ndërkombëtare në lidhje me përfshirjen efektive të refugjatëve duke e parë në këndvështrimin e qasjes në nivel lokal.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare dhe UNHCR Albania do të vijojnë këtë bashkëpunim edhe më tej, me qëllim krijimin e një situatë mundësuese për refugjatët dhe azilkërkuesit për akses në shërbimet financiare dhe integrimin e tyre të shpejtë në vendin tonë.



4.1.3 Shoqata Mikrofinanca Shqiptare në bashkëpunim me Institutin e Audituesve të Brendshëm (AIIA) organizuan seminarin me temë: "Standardet e Auditit të Brendshëm dhe përmirësimi i tyre" 4 Dhjetor, 2023

Ky seminar informues dhe interaktiv u organizua për herë të parë, në kuadër të bashkëpunimit të mëtejshëm dhe shkëmbimit të përvojave profesionale në fushat me interes të ndërsjelltë midis AMA dhe AIIA.

Të ftuar në këtë tryezë diskutimi ishin përfaqësues të departamenteve të Auditit të brendshëm nga institucionet anëtare të AMA-s dhe anëtarë bordi nga Instituti i Audituesve të Brendshëm.

Znj. Dorida Stambolla, anëtare bordi e Institutit të Audituesve të Brendshëm, bëri një prezantim të

detajuar mbi Standardet e reja Globale të Auditit të Brendshëm dhe theksoi se nga viti i ardhshëm deri në fund të 2024 do të jetë periudha e vlefshme për rishikimin e legjislacionit lokal dhe përafrimit të tij me atë ndërkombëtar.

Z. Astrit Aliqaj, Kryetar Bordi i Institutit të Audituesve të Brendshëm (AIIA) bëri një prezantim të shkurtër të krijimit të Institutit të Audituesve të Brendshëm, tashme me një eksperiencë mbi 10 vjeçare. AIIA promovon rolin e audituesit të brendshëm, rritjen e fokusit dhe performancën e lartë të këtij profesioni.

Krijimi i këtij bashkëpunimi të ri midis Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (AMA) dhe Institutit të Audituesve të Brendshëm (AIIA), është një urë lidhëse komunikimi dhe ndërveprimi për bashkërendimin efektiv të aktiviteteve të përbashkëta.

4.1.4 Në kuadër të Javës së Integritetit, Shoqata Mikrofinanca Shqiptare zhvilloi një tryezë diskutimi me temë: “Qeverisja Korporative në Institucionet e Mikrofinancës”, 11 Dhjetor 2023

Drejtesit e departamenteve ligjorë dhe të përputhshmërisë të institucioneve anëtare të AMA-s diskutuan mbi kuadrin ligjor dhe rregullativ për qeverisjen e institucioneve të mikrofinancës me znj. Ermira Curri (Tepelena) nga Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Në këtë seminar u paraqit një tablo mbi parimet dhe rregullat bazë të drejtimit të përgjithshëm efektiv duke theksuar rëndësinë e organeve drejtuese si dhe sistemin e

administrimit të rrezikut.

Sekretarja e Përgjithshme e Ama-s përshëndeti pjesëmarrësit dhe falenderoi znj. Curri për praninë e saj në këtë event. Më tej shtoi rëndësinë e ndërveprimit dhe shkëmbimit të informacioneve midis anëtarëve dhe rregullatorit.

Znj. Ermira Curri bëri një prezantim të detajuar mbi kuadrin ligjor dhe rregullativ për qeverisjen e institucioneve të mikrofinancës duke paraqitur një tablo mbi parimet dhe rregullat bazë të drejtimit të përgjithshëm efektiv duke theksuar rëndësinë e organeve drejtuese si dhe sistemin e administrimit të rrezikut.



4.2. DITA EUROPIANE E MIKROFINANCËS 2023

4.2.1 Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mban eventin vjetor me temë: “Digjitalizimi i Mikrofinancës: Nxitës i përfshirjes dhe qëndrueshmërisë financiare në Shqipëri”.

Dita Europiane e Mikrofinancës-26 Tetor 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare organizoi për herë të pestë eventin në kuadër të Ditës Evropiane të Mikrofinancës dhe këtë vit me temë: “Digjitalizimi

i Mikrofinancës: Nxitës i përfshirjes dhe qëndrueshmërisë financiare në Shqipëri”.

Të ftuar ishin përfaqësues të lartë nga institucionet shtetërore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Banka e Shqipërisë dhe përfaqësues të institucioneve financiare ndërkombëtare si: World Bank Albania, EBRD, KfW Bankengruppe Embassy of Switzerland in Albania EU4Innovation etj. Gjithashtu morën pjesë përfaqësues të komunitetit e shoqatave sektoriale,

institucione financiare jo-banka e dashamirës të aktivitetit të mikrofinancës, të cilët kanë ofruar mbështetje për sektorin në vijimësi.

Aktiviteti u përshëndet nga Z. Eduard Shalsi, Kryetar i Komitetit të Ekonomisë dhe Financave i cili theksoi që tema e kësaj dite është shumë aktuale dhe e rëndësishme për sistemin financiar në tërësi. Ai theksoi rëndësinë e institucioneve të mikrofinancës për atë pjesë të popullsisë që nuk ka një qasje në tregun bankar dhe ftoi të gjithë institucionet të bëjnë më shumë për të informuar publikun e gjerë dhe në veçanti media dhe politikëbërësit mbi impaktin që sektori ka në jetën e qytetarëve dhe bizneseve të vogla. Transparenca është një tipar që duhet të mbizotërojë në sektor dhe me këtë mesazh ai falenderoi shoqatën për ftesën.

Z. Deniz Dërralla, Drejtor i Mbikëqyrjes falenderoi dhe shprehu mbështetjen në emër të Bankës së Shqipërisë për të gjithë institucionet e mikrofinancës, për të gjithë punën shumë të mirë dhe të rëndësishme që kanë bërë në gjithë këto vite për të gjithë sistemin financiar, me një rritje gati trefish të veprimtarisë së tyre. Inkurajoi të gjithë për të vazhduar punën e mirë të deritanishme për të qenë më produktiv dhe më eficient edhe falë hapave të rëndësishëm që Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë në kuadër të digjitalizimit të sektorit financiar.

Në fjalën e saj zj. Arlinda Muja, Presidente e AMA falenderoi të gjithë bashkëpunëtorët, partnerët dhe mbështetësit në rrugën e gjatë dhe plot sfida që mikrofinanca ka kaluar përgjatë këtyre 30 viteve.



Ajo u shpreh në emër të të gjithëve se institucionet mikrofinanciare në vend do të vazhdojnë t'i shërbejnë pjesës së shoqërisë me të ardhura financiare më të ulëta, nisur edhe nga misioni social i mikrofinancës. Paraqiti gjithashtu edhe objektivat parësorë të institucioneve anëtare të mikrofinancës ku ndër më kryesorët janë:

1) Rritja e aksesit në financë 2) Krijimi i vendeve të punës 3) Zgjerimi i përfshirjes financiare 4) Zhvillimi teknologjik për përmirësim të vazhdueshëm të produkteve dhe shërbimeve.

Rëndësi të veçantë dhe përpjekje galopante janë bërë dhe do vazhdojnë të bëhen në procesin e gjatë të edukimit financiar, gjithashtu edhe në mbështetjen e veprimtarisë bujqësore të qëndrueshme.

Eventi shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të forcimit të dialogut të sektorit mikrofinanciar me qeverinë, institucionet financiare zhvillimore, aktorët e tregut si edhe me komunitetin e biznesit, duke u konsideruar në këtë mënyrë një event i suksesshëm nga partnerët dhe pjesëmarrësit.

4.3. KONFERENCA E 25-VJETORE E MICROFINANCE CENTRE (MFC)-JUBILEU I ARGJENDTË

4.3.1 Konferenca e 25-të vjetore e organizuar nga Qendra për Mikrofinancën (MFC), me temë: "Të lulëzojmë së bashku", 24-25 Maj 2023, Budva

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare merr pjesë në Konferencën e 25-të Vjetore të organizuar në Budva të Malit të Zi nga Microfinance Centre (MFC) me temë: "Thriving together".

Në këtë veprimtari që shënon 25-vjetorin e Rrjetit Ndërkombëtar të Mikrofinancës MFC, mikrofinanca shqiptare përfaqësohet nga stafet drejtuese të të gjithë anëtarëve të saj, të cilët angazhohen në diskutime dhe rrjetëzim me pjesëmarrësit. Microfinance Centre është një rrjet i financës sociale që promovon drejtësinë, gjithëpërfshirjen, barazinë dhe përgjegjshmërinë në ofrimin e shërbimeve financiare. Rrjeti bashkon rreth



100 organizata nga 36 shtete të Europës dhe Azisë Qendrore, të cilat së bashku ofrojnë produkte dhe shërbime mikrofinanciare për rreth 2 milion klientë më të ardhura të ulëta.

Fjala e hapjes së Konferencës Vjetore të Microfinance Centre u mbajt nga Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare dhe Kryetare në

largim e Këshillit Mbikëqyrës së MFC, znj. Brunilda Isaj. Konferenca i vazhdoi punimet e saj edhe ditën e dytë ku nga zgjedhjet e reja për Këshillin e MFC, u zgjodh z. Perlat Sulaj, administrator i Fed Invest si anëtar i ri i zgjedhur i Këshillit të MFC. Në tjetër arritje për shoqatën mikrofinanca shqiptare në bashkëpunim me Microfinance Centre.

4.4. SOCIAL FINANCE VIBE 2023

4.4.1 Konferenca Virtuale SFV 2023 me temë: "Fuqizimi i së ardhmes" 21-22 Nëntor, 2023



Social Finance Vibe 2023 ishte edicioni i tretë i konferencës virtuale të organizuar nga Qendra për Mikrofinancën (MFC) me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe partnerëve të tjerë.

Anëtarë të AMA morën pjesë në Konferencën Virtuale SFV 2023 me temë: "Fuqizimi i së Ardhmes" e organizuar nga Microfinance Centre (MFC) me mbi 400 pjesëmarrës të pranishëm, 60 spikerë të rëndësishëm dhe 20 sesione të zhvilluara në eventin dy-ditor më të madh të financave sociale.

Këtë vit, konferenca u ndërtua rreth tre temave kryesore:

ekonomia sociale, grupet vulnerabël dhe mega trendet.

Në ditën e dytë të konferencës, z. Perlat Sulaj anëtar i këshillit mbikëqyrës i MFC, administrator i Fed Invest ishte panelist në sesionin dedikuar financave gjithëpërfshirëse dhe zhvillimit rural. Ndër të tjera theksoi angazhimin e kontributin në zhvillimin e bujqësisë së qëndrueshme dhe transformimin e financave sociale në ekonominë rurale.

Konferenca ishte një hapësirë unike shkëmbimi eksperiencash mes liderësh dhe ekspertë të mikrofinancave europiane.

SOCIAL FINANCE VIBE EMPOWERING THE FUTURE

21-22 November
#SFV2023



Social Economy

Vulnerable Groups

Mega Trends

për ndryshimet që priten në lidhje me nismat ligjore për linjëzimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ me acquis të BE etj. Shumë sugjerime me vlerë u dhanë për audituesit e brendshëm që do të shërbejnë si prioritet për aktivitetet e Institutit për vitin 2024.

Ndryshimet dhe risitë janë duke ndodhur për shkak të: krizave botërore, pandemisë, konflikteve

gjeopolitike, inteligjencës artificiale, punës hibride, revolucionit dixhital etj, dhe të gjithë duhet të përgatitemi për ta mirëpritur, pavarësisht se në cilin funksion shërbejmë në institucione. Audituesit e brendshëm janë shumë mirë të pozicionuar të ndihmojnë si “agjentë” për këtë ndryshim në të mirë të institucioneve dhe të shoqërisë sonë.



4.5. KONFERENCA VJETORE E AUDITUESVE TË BRENDSHËM

4.5.1 Konferenca Vjetore e Audituesve të Brendshëm ,12 Dhjetor 2023

Në datën 12 Dhjetor 2023 u zhvillua Konferenca Vjetore e Institutit Shqiptar të Audituesve të Brendshëm për vitin 2023. Tema kryesore e konferencës ishte: **“Rruga drejt ndërtimit të besimit”**.

Mikrofinanca Shqiptare u përfaqësua nga Presidentja e Shoqatës znj. Arlinda Muja njëkohësisht drejtore ekzekutive e Kredo Finance e cila ishte folëse në panelin e dytë me temë: **“Reziqet e shfaqura në mjedisin lokal”**.

Panelët mundësuan diskutimet në nivele më praktike për çështje me shumë interes si transparenca, besimi

dhe roli kryesor që luan etika në ndërtimin e besimit brenda institucioneve ku punojmë dhe shoqërisë sonë.

Paneli i dytë solli një temë tepër aktuale si risqet e reja në mjedisin vendas dhe si duhet të zhvillohet Auditimi i Brendshëm për t’iu përshtatur këtyre tendencave. Panelistët e ftuar me njohuri të shkëlqyera të tregut shqiptar, në aspekte të ndryshme të tregut, sollën një diskutim praktik dhe me shumë vlerë për pjesëmarrësit në lidhje me të rejtat e pritshme në tregun vendas dhe sfidat që hasin institucionet në një botë dinamike e në ndryshim të vazhdueshmëm.

Midis risqeve më kryesore në tregun vendas, u përmendën mungesa e profesionistëve të kualifikuar, siguria kibernetike, digjitalizimi, forcimi i kapaciteteve

5 NGJARJE SHËNJUESE

5.1 EMETIMI I OBLIGACIONIT TË PARË PRIVAT ME OFERTË PUBLIKE

5.1.1 Moment historik - obligacioni i parë privat me ofertë publike, 24 Maj 2023

Noa sh.a institucioni financiar jo-bankë, anëtar shumë i rëndësishëm i Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare pararendës në listimin në Bursën Shqiptare të titullit të parë jo-qeveritar. Përgëzime për festimet ceremoniale në kuadrin e 25-vjetorit të krijimit të këtij institucioni e gjithashtu këtë ngjarje që shënon një moment historik në tregun sekondar të financave duke hapur rrugën investimeve në tregjet e kapitalit të sektorit privat për këto instrumente.

Tashmë obligacioni i emetuar do të kuotohet edhe në Bursën Shqiptare të Titujve duke bërë atë të parin titull të një subjekti privat që mund të tregtohet lirisht

në bursë, pasi deri më tani tregtimi publik i titujve ka qenë i mundur vetëm për letrat me vlerë të emetuara nga qeveria. Bondi ka një afat 5 vjeçar dhe interes vjetor fiks 8% që paguhet çdo 6 muaj.

Obligacioni është i pagarrantuar, i nënrenditur dhe u emetua në monedhën Lekë me vlerë minimale 500 mijë lekë. Kjo do të thotë se në radhën e shlyerjes së detyrimeve ky instrument vjen i fundit, por gjithsesi qëndron para aksionerëve.

Efektin zinxhir- Listimi në Bursë i bën titujt financiarë likuidë, që mund të tregohet në çdo moment duke u krijuar mundësinë investitorëve t'i shesin dhe blejnë lirisht ato. Kjo krijon mundësi të reja për tregun financiar.



5.2 MANDATI I TRETË NË KRYE TË SHOQATËS MIKROFINANCA SHQIPTARE

5.2.1 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare (AMA) zhvilloi takimin e fundvitit për të diskutuar dhe miratuar Plan-Buxhetin 2024 dhe votimin e Presidentit të radhës që do të drejtojë shoqatën për një mandat 2 vjeçar 2024-2026. Anëtarët me votë unanime miratuan mandatin e tretë të znj. Arlinda Muja si Presidente të AMA

Në një vazhdimësi të përkryer suksesi dhe përkushtimit të palëkundur ndaj sektorit të mikrofinancës në Shqipëri, znj. Arlinda Muja, Drejtoreshë e Përgjithshme e Kredo Financë, gëzon një tjetër shpërblim të merituar. Ajo është zgjedhur për herë të tretë radhazi si Presidente e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, një

pozitë e cila tregon jo vetëm profesionalizmin e saj të rrallë në fushën e shërbimit të mikrokredive, por edhe përkushtimin e vazhdueshëm për zhvillimin e sektorit të mikrofinancës në vend.

Kredo Financë ka qenë një forcë e rëndësishme në sektorin e mikrofinancës në Shqipëri, duke ofruar shërbime financiare të ndryshme për komunitetin lokal. Znj. Arlinda Muja, ka udhëhequr me pasion dhe vizion, duke ndihmuar në rritjen e aksesit të individëve dhe bizneseve të vogla në burimet financiare.

Zgjedhja e znj. Arlinda Muja për herë të tretë radhazi si Presidente e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare është një njohje e qartë e kontributit të jashtëzakonshëm të saj në fushën e mikrofinancës. Ky votim i besimit nga ana e anëtarëve të shoqatës tregon se ajo është një



udhëheqëse e respektuar dhe një eksperte e njohur në këtë fushë.

Si Presidente e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, znj. Arlinda Muja ka shpallur një vizion të qartë dhe prioritete të rëndësishme për të ardhmen e sektorit të mikrofinancës në vend. Ajo ka shprehur qëllimin e saj për të thelluar bashkëpunimin mes institucioneve financiare mikro, aktorëve të tjerë të sektorit si dhe institucioneve rregulluese të këtij sektori, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe ofrimit të mundësive të reja për klientët.

Përveç kësaj, znj. Arlinda Muja është përkushtuar në përmirësimin e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin

e komunitetit në lidhje me avantazhet dhe rreziqet e shfrytëzimit të shërbimeve financiare. Kjo përpjekje synon të ndihmojë në rritjen e ndërgjegjësimit financiar dhe përmirësimin e aftësive të menaxhimit financiar për individët dhe komunitetet në nevojë.

Zgjedhja e znj. Arlinda Muja për herë të tretë radhazi si Presidente e Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare është një dëshmi e qartë e respektit dhe vlerësimit të punës së saj në fushën e mikrofinancës. Duke qenë në krye të Kredito Finance dhe Shoqatës Mikrofinanca Shqiptare, ajo shërben si një model frymëzues për të gjithë ata që angazhohen në zhvillimin e sektorit financiar në Shqipëri.

6 KËRKIME DHE PUBLIKIME

6.1. SONDAZHI NË LIDHJE ME PRITSHMËRITË EKONOMIKE PËRGJATË VITIT 2024

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare publikon indikatorët financiarë për vitin 2023 dhe rezultatet e sondazhit mbi pritshmëritë ekonomike të qytetarëve për vitin 2024

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mbajti një takim me gazetarë të ekonomisë dhe përfaqësues të mediave në vend, për të përcjellë informacion në lidhje me veprimtarinë e sektorit gjatë vitit 2023, si edhe planet dhe pritshmëritë për të ardhmen.

Gjatë takimit u parashtruan sfidat e ekonomisë shqiptare të parë nga këndvështrimi i individëve, roli i mikrofinancës në nxitjen e ekonomisë vendase dhe rëndësia thelbësore e këtyre institucioneve në zhvillimin teknologjik të sektorit financiar dhe edukimin financiar të individëve të shërbyer.

a) Veprimtaria e sektorit të huadhënies jo-bankare dhe mikrokredisë

Sektori i mikrofinancës në fund të vitit 2023, rezultoi me 200 mijë klientë aktivë dhe mbi 255 mijë kredi të disbursuara. Volumi i kredive të disbursuara ka arritur në 36.6 miliardë lekë, apo afërsisht 360 milionë euro, nga 34 miliardë në vitin 2022. Ndërkaq, kredia me probleme (NPL) ka rënë në nivelin 6.1 % nga 7.2 % në vitin 2022.

Vendin e parë në portofolin e anëtarëve e zënë bizneset të të gjitha llojeve (51 %) e më pas individët (36 %). Ndërkohë e parë nga numri i kredive sektori i mikrofinancës është i fokusuar më së shumti tek individit që zë 80 % të kredive aktive.

Ndërkohë që aktiviteti kredidhënës ka patur rritje të konsiderueshme me një portofoli aktiv kredie prej 44 miliardë lekë apo rreth 440 milionë euro.

Sipas të dhënave zyrtare të anëtarëve të AMA, sektori numëron 1,919 të punësuar, prej të cilëve 951 oficerë kredie. 9 institucionet e mikrofinancës numërojnë në total një rrjet prej 290 degësh të shtrira në gjithë vendin.

Shqipëria vazhdon të ketë një kërkesë të fortë për produktet e mikrofinancës. Shumica e IFJB-ve shqiptare ndjekin një politikë të përgjegjshme sociale që synon individë të përjashtuar financiarisht dhe zona gjeografike të pafavorizuara.

b) Kërkim tregu mbi gjendjen ekonomike të qytetarëve për vitin 2023 dhe pritshmëritë ekonomike të tyre për vitin 2024

Disa nga përfundimet e nxjerra nga ky sondazh informojnë se:

- 52% e të intervistuarve kanë disa burime të ardhurash.
- Burimi i të ardhurave që prevalon vjen nga sektori privat.
- 27% e të punësuarve në shtet kanë një burim të dytë të ardhurash nga qeraja dhe punësimi në biznes privat.
- 50% e pensionistëve të intervistuar deklarojnë se janë të punësuar në sektor privat.
- 93% e individëve të intervistuar deklarojnë se viti 2023 ka patur ndikim disi negativ ose negativ në të ardhurat e tyre.
- Vetëm 8% e të intervistuarve kanë arritur të kursejnë para për investim/blerje.
- 74% e të intervistuarve deklarojnë se mund të përballojnë shpenzimet mujore por kursimi i parave është i vështirë.
- 42% e të intervistuarve janë munduar të ulin shpenzimet për të mos marrë kredi gjatë vitit 2023, kjo pasi ata kanë tashmë një të tillë.
- 40% e të intervistuarve kanë hasur tepër vështirësi dhe u është dashur të marrin kredi.
- 58% e të intervistuarve kanë deklaruar se kanë të ardhura për blerje të domosdoshme jetike.
- 16.5% e të intervistuarve nuk mund të blejnë as rroba dhe veshmbathje. Këtu përfshihen kategoritë e pensionistëve.
- 95% e të intervistuarve deklaruan se shpenzimet familjare, përqëndrohen tek pagesa e faturave utilitare.
- 60% e të intervistuarve deklaruan se kishin makinë në shtëpi dhe ju nevojitej një buxhet për mirëmbajtjen e saj.
- Veshjet, farmaceutika, kontrollet mjekësore,

edukimi i fëmijëve realizoheshin si shpenzime tek 50% e të intervistuarve.

15. Mbi 80% e të intervistuarve deklaruan nuk do të bëjnë ristrukturim banese apo blerje makine.
16. Të intervistuarit deklaruan se përdorin një ose më shumë mjete financuese.
17. Të intervistuarit kanë përdorur paralelisht disa nga shërbimet njëkohësisht, si psh edhe kartën e kreditit edhe kredinë bankare.
18. Një numër jo i vogël nga të intervistuarit kanë

marrë kredi në një institucion financiar jo bankë dhe paralelisht kanë përdorur edhe produktet bankare.

19. Vetëm 16% e të intervistuarve konsiderojnë ende borxhin nga të afërmit, pjesa tjetër drejtohet në institucione financiare.

E ardhmja mbetet sfiduese me ndryshime të shpeshta në ekonomi që shoqërohen me uljen e shpenzimeve familjare dhe administrimin me kujdes të të ardhurave.

6.3 FUSHATA HUAMARRJE E ZGJUAR 2023

6.3.1 "Mikrofinanca për Sipërmarrjen e Grave"

Fushata "Huamarrje e Zgjuar" edicioni i 9-të i saj promovon standardet globale të kreditimit të përgjegjshëm dhe kujdesit ndaj klientit. Kjo fushatë vjetore ndërkombëtare drejtohet nga Microfinance Centre (MFC) dhe partnerët e saj.

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare së bashku me disa nga anëtarët e saj janë anëtarë krenarë të këtij rrjeti me kontribute të vlefshme që përpiqet për drejtësi, mundësi të barabarta dhe etikë në ofrimin e shërbimeve financiare.

Tematika e këtij viti ishte "Mikrofinanca për Sipërmarrjen e Grave". Kjo fushatë, e organizuar nga Microfinance Centre (MFC) anëtarët e saj, fokusohet në tejkalimin e hendekut gjinor dhe promovimin e rolit dhe ndikimit transformues të mikrofinancës në financimin dhe fuqizimin e grave sipërmarrëse.

Komponenti digjital ishte theksi i këtij edicioni të fushatës "Huamarrje e zgjuar". Përmirësimi i aksesit, udhëzime dhe rekomandime për optimizimin e shërbimeve, promovimin e produkteve dhe ofrimin e opsioneve të përshtatshme të pagesës dhe mjete të tjera që derivojnë në suksesin e bizneseve në epokën digjitale.



7 LOBIMI DHE ADVOKIMI

7.1. MARRËDHËNIET ME BANKËN E SHQIPËRISË

Institucionet financiare jo-banka dhe Shoqëritë e Kursim-Kreditit janë subjekte financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë. Mikrofinanca Shqiptare mban raporte të ngushta dhe bashkëpunon me Bankën e Shqipërisë në drejtim të përfaqësimit të anëtarëve të shoqatës, në drejtim të përmirësimit dhe ndryshimeve të aplikuara në planin rregullator, si edhe të shkëmbimit të informacionit cilësor dhe sasior të shkëmbyer në drejtim të ecurisë së sektorit dhe tendencave të vërejtura brenda tij në raport me ambjentin ekonomik dhe financiar të vendit në përgjithësi.

Kontakte të vazhdueshme Shoqata ka mbajtur me Bankën e Shqipërisë sa i takon ndryshimeve rregullatore dhe krijimin e një mjedisi të shëndetshëm financiar në mënyrë që të krijohet mbështetja e duhur për të gjitha segmentet e tregut dhe ekonominë në përgjithësi.



7.1.2 Mbledhja e komitetit teknik për strategjinë kombëtare të edukimit financiar, 15 Qershor 2023

15 Qershor 2023, u mbajt mbledhja e parë e komitetit teknik në kuadër të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare për Edukimin dhe Përshtirjen Financiare ku AMA është pjesë integrale e këtij komiteti.

7.1.1 Mbledhja e IX e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, 13 Dhjetor 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mori pjesë në mbledhjen e IX të Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave, e cila u zhvillua në datë 13 dhjetor 2023 nën drejtimin e Zv. Guvernatorese së Parë dhe njëkohësisht Kryetare e këtij Komiteti, znj. Luljeta Minxhozi.

Mbledhja e Komitetit vijoi me prezantime dhe diskutime teknike mbi kriteret e anëtarësimit në SEPA dhe kërkesat për Shqipërinë; zbatimin e projektit mbi pagesat e shpejta;

AMA shprehu vlerësimin për finalizimin e Strategjisë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare dhe shprehu angazhimin e anëtarëve për të kontribuar në projektet dhe iniciativat e ardhshme me qëllim përmirësimin e edukimit financiar në vend.

E organizuar nën kujdesin e veçantë të Zëvendësguvernatores së Parë të Bankës së Shqipërisë, znj. Luljeta Minxhozi, kjo mbledhje shërbeu për të vendosur piketat e para të bashkëpunimit të ardhshëm, për t'u njohur më nga afër me projektet aktuale dhe synimet e institucioneve në këtë fushë, si dhe për të përcaktuar afatet dhe objektivat e SKEPF.

7.2. MARRËDHËNIET ME QEVERINË DHE AKTORËT E TJERË TË TREGUT FINANCIAR

7.2.1 Këshilli i Investimeve, 6 Tetor 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ishte pjesëmarrëse në mbledhjen ad hoc të thirrur nga Këshilli i Investimeve, e kryesuar nga Ministri Financave dhe Ekonomisë z. Ervin Mete. Në qendër të diskutimeve ishte cilësia shërbimeve publike në ndërveprim me sektorin publik.

Sektori i mikrofinancës mbështet nismat e ndërmarra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe shpreh gatishmërinë për të qënë një faktor kontribues në këto nisma, në mbështetje të mëse 270 mijë klientëve të tij, biznese, mikrondërmarrje dhe fermerëve shqiptarë.



7.2.2 Mbledhja e radhës e Këshillit të Investimeve, 15 Dhjetor 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare mori pjesë në Mbledhjen e radhës së Këshillit të Investimeve thirrur


nga ministri i Financave dhe Ekonomisë z. Ervin Mete. Programi i Reformave Ekonomike **2024-2026** ishte fokusi i diskutimeve dhe konsultimi i këtij dokumenti me institucionet shtetërore, përfaqësuesit e biznesit dhe partnerët ndërkombëtarë.



7.2.3 Tryezë diskutimi "Rritja e aksesit në financime për bujqësinë", 10 Mars 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare ishte paneliste në takimin e organizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Banka e Shqipërisë, me anë të drejtorit të përgjithshëm të Fed Invest, z. Perlat Sulaj. Ky takim

bashkoi institucionet tona të mikrofinancës dhe shoqëritë e kursim-kreditit dhe përfaqësues të fermerëve për të diskutuar mbi funksionimin e të gjitha hallkave të ndërveprimit mes aktorëve të këtij zinxhiri, si dhe rritjen e mëtejshme të aksesit në financime për fermerët dhe agropërpunuesit.



7.2.4 Takim konsultativ për ligjin mbi Sigurinë Kibernetike, 10 Nëntor 2023

Shoqata Mikrofinanca Shqiptare së bashku me anëtarët e saj u takuan me përfaqësues të Autoritetit Kombëtar CESK për të diskutuar mbi projektligjin "Për Sigurinë Kibernetike". Anëtarët rekomanduan që klasifikimi dhe kategorizimi i IFJB-ve si infrastruktura të rëndësishme apo kritike duhet të bëhet duke patur parasysh llojin e shërbimeve apo impaktin që këto institucione kanë në ekonomi dhe të lidhet tërësisht me aktivitetin e tyre primar.

Z. Igli Tafa, drejtor i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar CESK, tha në fjalën e tij që autoriteti ka për qëllim të garantojë që të gjitha subjektet të implementojnë standardet bazë për garantimin e sigurisë së informacionit.

Autoriteti Kombëtar premtoi që do të jetë bashkëpunues me sektorin dhe garantoj se Shoqata Mikrofinanca Shqiptare do të jetë pjesë e procesit të konsultimeve të mëtejshme dhe konkretisht të metodologjisë së re për identifikimin e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të sigurisë së informacionit.



Shoqata
Mikrofinanca
Shqiptare



Albanian
Microfinance
Association

**MIKROFINANCA
SHQIPTARE
2023**